




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 400/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Bereqeti-ing” shpk - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE: NTP “Beni” - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe ndërtimi i parqeve – kontratë dy vjeçare”, me numër të prokurimit: 632/18/4669/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, më datë: 31.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Bereqeti-ing” shpk - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe ndërtimi i parqeve – kontratë dy vjeçare”, me numër të prokurimit: 632/18/4669/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë.

II. VËRTETOHET njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Sanimi dhe ndërtimi i parqeve – kontratë dy vjeçare”, me numër të prokurimit: 632/18/4669/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Bereqeti-ing” shpk - Prishtinë, refuzohet i bëhet konfiskimi tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 26.06.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt:02.07.2018, ku kanë marrë pjesë tre (3) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: “Bereqeti-ing” shpk - Prishtinë, tenderues i pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 30.07.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: “Bereqeti-ing” shpk - Prishtinë, me dt: 02.08.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 03.08.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: “Bereqeti-ing” shpk - Prishtinë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “Bereqeti-ing” shpk - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 08 Gusht 2018, me nr. 400/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Sanimi dhe ndërtimi i parqeve – kontratë dy vjeçare”, me numër të prokurimit: 632/18/4669/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59, 60, 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 10.08.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 16.08.2018, sqaron:

Kemi një pretendim ankimor për të cilën është eliminuar OE ankues, në lidhje me nenin 72 dhe 59.2 të LPP-së sa i përket marrëveshjes për shfrytëzimin të makinerisë. Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit të ofertave ka vepruar në harmoni me nenin 59.2 të dhe 72 të LPP-së në lidhje me këtë dokument gjatë ekzaminimit të ofertës duke shfrytëzuar të drejtën për sqarime apo plotësime të dokumentit marrëveshja për shfrytëzimin të pajisjeve të ofruara nga OE ankues, por i njëjti dokument është ofruar i ndryshuar nga OE ankues ku data e dokumentit përmban datën 18.07.2018, që bie nënesh me paragrafin 3 të nenit 72 të LPP-së ku thuhet: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimit të informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, duke u bazuar në këtë paragraf, dokumenti i cili grindet në dosjen origjinale të OE ankuese i cili është dorëzuar gjatë ofertimit në këtë aktivitet përmban datën 17.07.2018, që është përpiluar para datës së hapjes siç parashihet me paragrafin e lart cekur, ndërsa dokumenti i ofruar nga OE ankues gjatë sqarimeve shtesë përmban datën 18.07.2018.

Duke u bazuar në sqarimet e lart përmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "Bereqeti-ing" shpk – Prishtinë të Refuzohet si pa-bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigjja në pretendimet e lart cekura), njërit rekomandojmë që ky aktivitet i prokurimit të vazhdojë më tutje në harmoni me LPP.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Gjakovë, me datë: 16.08.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: "Bereqeti-ing" shpk - Prishtinë, me datë: 17.08.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 31.08.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,

njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrirat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Mazreku deklaroj: Ne si OE lidhur me këtë aktivitet dëshmojmë se kemi dorëzuar prapë që na ka eliminuar AK, ku është e lidhur te fjala Bager dhe Ekskavator është e njëjta gjë, këtë mund ta konfirmoni edhe me fjalorë apo në konsultim me ekspertët e lemisë. Edhe pse ka ardhur deri te faza e ankesës edhe pse nuk ka pas nevojë, sepse në pjesën e parë listën e parë janë të prezantuara më faturë sipas dispozitave ligjore të prokurimit, ku duhet prezantuar me faturë, dudë doganor, ose marrëveshje. Edhe pse jemi eliminuar sipas kësaj të parës, ne kemi pas të gjitha dokumentacionet prezentë. Po ashtu sa i përket dëshmive të kërkuara, ne i kemi ato në ofertën tonë, dhe oferta është bërë sipas sistemit elektronik. Për pjesën e dytë, ne jemi detyruar të bëjmë ankesë për rishqyrtim të dokumentacionit, pas ankesës së bërë ne kemi dorëzuar marrëveshjet e konfirmuara të bëra me datë 18 ku është thirrë me datë 17 dhe 18. Data 17 ka qenë marrëveshje përgjithshme e makinerisë për përdorimin në për gjitha tenderët, ndërsa data 18 ka qenë dita kur është hap në ora 2 tenderi. Ne marrëveshjet i kemi pas të specifikuara sepse atë ditë është përgatit gjithë dokumentacioni nevojshëm. Me datë 18 kemi paraqitur marrëveshje që ka qenë marrëveshja e kryer edhe pse për një gabim të vogël që nuk është proceduar në sistemin elektronik si marrëveshje ka qenë e datës 18 që ma lejon ligji neni 72 ku thotë se kur dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga OE është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar , ose kur mungojnë dokumente specifike AK-të mund të kërkojnë nga OE-të që të dorëzojnë plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin. Me këtë ne kemi ofruar dokumentacionin e datës 18 , dhe brenda afatit ka qenë e zyrtarizuar marrëveshja për makinerinë sipas emërimit që kanë kërkuar. Ky dokumentacion ka ekzistuar dhe nuk është krijuar më vonë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KK Gjakovë z.Haxhija deklaroj: AK pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit se ka veprua konform LPP. Nuk do lëshohem gjatë, do ndalem te marrëveshjet e kontestuara. Marrëveshja e datë 17 ka qenë një marrëveshje tjetër, kurse pas kërkesës për sqarime OE ka sjell një marrëveshje tjetër të datës 18.07.2018, dhe pajisjet në këtë marrëveshje kanë dalluar nga ato të marrëveshjes 17.07.2018. Me që nuk është e noterizuar marrëveshja e datës 18.07.2018, nuk kemi si ta dëshmojmë se ajo vërtetë është bërë para hapjes. Marrëveshja e 18.07.2018 është krejtësisht dokument i ri.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z.Fazliu deklaroj: Fillimisht sqaroj se kemi të bëjmë me një pretendim ankimorë për ndryshim të marrëveshjes së pajisjeve. AK gjatë ekzaminimit të ofertave lidhur me marrëveshjet për huazimin e pajisjeve ka kërkuar sqarime sipas nenit 59 dhe 72 të LPP, sepse marrëveshja që gjendet në ofertën e OE ankues ka qenë e pa qartë dhe nuk ka përmbajtur gjitha pajisjet sipas kërkesës së

AK. Ajo marrëveshje ka qenë e nënshkruar me datë 17.07.2018 nga OE ankues dhe huadhënësi i pajisjeve. Pas kërkesës së AK për sqarime shtesë, OE ankues i ofron AK-së një marrëveshje me të njëjtin OE për huazim të pajisjeve por që ishte e ndryshme nga ajo paraprake për faktin se marrëveshja e re e ofruar nga OE ankues mbanë datën 18.07.2018 e cila e bënte të ndryshme nga ajo paraprakja sepse ajo mbante datën 17.07.2018. Vet fakti që kemi të bëjmë me data të ndryshme kemi të bëjmë me një marrëveshje të re. Po ashtu pajisjet e renditura në këtë marrëveshje ishin disa pajisje sipas renditjes të cilat nuk kishin qenë fare në datën 17.07.2018. Ne nuk kontestojmë se i njëjti ka mund të ketë marrëveshje me OE, mirëpo në marrëveshjen e re kishte pajisje të reja. OE ankues me drejtë thirret në nenin 72 për sqarime shtesë pasi e njëjta dispozitë i mundëson mirëpo paragrafi tre i nenit 72 thotë data e fiksimit të dokumentit duhet të jetë para datës së hapjes.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues z.Mazreku deklaroj: Ne kemi ofruar sqarimet brenda afatit prej dy ditëve ashtu siç është kërkuar prej AK-së. Lista makinerisë e dorëzuar nga ne përmban edhe pajisjet për të cilat konstaton eksperti se janë shtuar të reja. Realisht ato pajisje gjenden në listën e pajisjeve të ofruar nga ne. I propozojmë panelit të aprovoj ankesën dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Haxhija deklaroj: Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se autoriteti kontraktues (AK) gjatë vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave lidhur me marrëveshjet për huazimin e pajisjeve të ofruar nga OE ankues ka kërkuar sqarime sipas nenit 59 dhe 72 të LPP, sepse marrëveshja që gjendet në ofertën e OE ankues ka qenë e pa qartë dhe nuk ka përmbajtur të gjitha pajisjet sipas kërkesës së AK. Ajo marrëveshje ka qenë e nënshkruar me datë 17.07.2018 nga OE ankues dhe huadhënësi i pajisjeve. Pas kërkesës së AK për sqarime shtesë, OE ankues i ofron AK-së, një marrëveshje me të njëjtin OE për huazim të pajisjeve por që ishte e ndryshme nga ajo paraprake për faktin se marrëveshja e re e ofruar nga OE ankues mbanë datën 18.07.2018 e cila është e ndryshme nga ajo paraprakja sepse ajo mbante datën 17.07.2018 . Pajisjet e renditura në marrëveshje e re ishin disa pajisje sipas renditjes të cilat nuk kishin qenë fare në marrëveshjen e paraprake, dhe konstatohet fakti se në marrëveshjen e re të ofruar nga operatori ekonomik ankues te dt.18.07.2018, kishte edhe pajisje të reja, e që një veprim i këtillë është në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së, në të cilin thuhet: Autoriteti kontraktues

do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që të zbatojë të gjitha dispozitat e LPP-së, dhe njëkohësisht ti merr parasysh të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Komuna Gjakovë
- 1x1 OE "Bereqeti-ing" shpk - Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.